

Ne Fokus/ Fanatics "shampo per morra" Dukës dhe Jeminit

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 19 Tetor 2013 19:22



Tifozet e Tiranës nuk i kanë harruar akoma veprimet tendecioze që gjyqtari Lorenc Jemini bëri një javë më parë në derbin e humbur me Partizanin. Pak ditë pasi trajnerit Nevil Dede deklaroi se në FSHF kanë zënë morra, grupimi Fanatics ka gjetur një ide origjinale për të ironizuar FSHF-në dhe gjyqtarin Jemini. Fanatics i kanë nisur me poste në adresën e shtëpisë gjyqtarit Lorenc Jemini dhe presidentit të FSHF-së Armando Duka dy kuti me shampo kundër marrave. Ky veprim është pritur me entuziazëm nga tifozet e shumë të bardheblu që nuk harrojnë mënyrën se si Jemini i detyroi të humbisnin derbin.